



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:101844

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396932

KPPP.nr.1741/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Schenker DOOEL Shkup nga Shkupi të cilën me autorizim e përfaqëson avokati XH.B. nga Prishtina, kundër debitorit “Ugur ” Sh.P.K., nga Limitid Liability Company Mitrovicë, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbarim, jashtë seancës, me datë 22.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit Schenker DOOEL Shkup nga Shkupi të cilën me autorizim e përfaqëson avokati XH.B. nga Prishtina.
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin E.nr.85/16, të datës 18.05.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Mitrovicë, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbareme është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbareme, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbareme, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbareme (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbareme, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbareme. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbareme për përmbaremin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbaremit sipas propozimit për përmbaremin të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedure përmbareme të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbareme.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbareme është caktimi dhe zbatimi i përmbaremit nga gjykata si organ përmbaremes sipas propozimit për përmbaremin të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se Gjykata Themelore në Mitrovicë është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbareme, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa u tha më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbartimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1741/23, datë 22.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.